



Lëvizja pa viza: E domosdoshme të mbetet një histori suksesi
Balazs: Mos i humbisni prioritetet tuaja! Dhe mos u tregoni të paduruar!
Fule: Spiralja e rrezikshme kokëposhtë e Shqipërisë duhet të marrë fund

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.1, Janar - Shkurt 2011

Mbi EuroSpeak

EuroSpeak është një revistë e përdymuajshme, e pasur me informacion të përditësuar dhe analiza mbi çështje të integritimit evropian, me fokus të veçantë mbi zhvillimet e marrëdhënieve të BE-së me Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit. Nga vetë emri, EuroSpeak (gjuha e përdorur nga burokratët në Bruksel dhe shpeshherë e kuptueshme vetëm për ekspertët), revista është projektuar për të përcjellë tek publiku i gjerë në një gjuhë më të lexueshme dhe jo teknike thelbin e debateve në gjirin e institucioneve të BE-së. Ajo synon të zvogëlojë hendekun aktual informativ mbi tema të tilla duke aspiruar të propozojë analizë cilësore dhe të pavarur e cila shkon përtej listimit të thatë të fakteve apo deklaratave të politizuara mbi integritimin në BE që ndeshen shpesh në media. Përpos artikujve të shkruar nga stafi i revistës, lexuesi mund të gjejë dhe një përzgjedhje artikujsh të publikuar në mediat më të mira të specializuara në mbulimin e çështjeve të BE-së, duke kursyer kështu kohë për t'i kërkuar ato. Përmbledhjet apo ekstraktet e artikujve publikohen në zbatim të Ligjit Nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me Të". Nisma për të sjellë këtë organ të ri informimi frymëzohet nga përvoja e akumuluar deri më tani nga EMA për sa i përket analizimit dhe nxitjes së debatit mbi aspekte të ndryshme të integritimit, duke synuar kësaj here që të informojë një audiencë më të gjerë e cila ushqen interes për zhvillimet në BE dhe procesin e zgjerimit të saj.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri – OSFA.

Në fokus

Lëvizja pa viza: E domosdoshme të mbetet një histori suksesi

Vështirë t'i ketë shpëtuar ndokujt në vendin tonë lajmi se që nga 15 dhjetori 2010, qytetarët shqiptarë (dhe ata të Bosnje-Hercegovinës) më në fund, mund të lëvizin pa viza në hapësirën Shengen. I vonuar me një vit në krahasim me vende fqinje të përfshira në të njëjtin proces, vendimi nga institucionet e BE-së, mbyll kalvarin e izolimit të padrejtë, procedurave burokratike dhe të kushtueshme të aplikimeve për vizë dhe trajtimit jo-dinjtoz të qytetarëve në ambasada.

(vazhdon në faqen 2)



Në foto: C. Malmstrom
Komisionere e KE

Nga përvoja me zgjerimin



Balazs: Mos i humbisni prioritetet tuaja! Dhe mos u tregoni të paduruar!

Intervistë me Peter Balazs, Ministër i Punëve të Jashtme i Hungarisë (vitet 2009 - 2010) dhe Komisioner i BE-së për Politikën Rajonale (viti 2004)

EuroSpeak: Z. Balazs, kur zë fill angazhimi juaj në çështjet e integritimit evropian?

Balazs: Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj duhet të kthehem disa dekada mbrapa. Karriera ime në çështjet e integritimit evropian filloi që në vitin 1969, kur u rekrutova nga Ministria e Punëve të Jashtme si specialist

(vazhdon në faqen 4)

Lëvizja pa viza: E domosdoshme të mbetet një histori suksesi



(vijon nga faqja 1) Shqiptarët vazhdojnë t'i gëzohen përfitimeve që ka sjellë lëvizja pa viza për ta si individë, ndonjëherë ende të paqartë mbi perceptimin nëse "hynë në Europë" apo thjeshtë fituan të drejtën të udhëtojnë për

një numër të kufizuar ditësh. Ekzistojnë gjithashtu edhe një sërë aspektesh të tjera pozitive për tu marrë në konsideratë në një plan më të përgjithshëm të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Së pari, duke parashikuar kushtëzime konkrete, procesi i liberalizimit të vizave i ka shtyrë autoritetet shtetërore të kenë një qëndrim të orientuar drejt arritjeve konkrete dhe jo angazhimeve të mbetura në letër. Së dyti, ky proces ka kontribuar në forcimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta mes institucioneve të BE-së dhe aktorëve të shoqërisë civile në Shqipëri, një përvojë e cila duhet ruajtur dhe intensifikuar në hapat e tjerë të procesit të integritimit. Së treti, lëvizja pa viza në hapësirën Shengen mund dhe duhet të shërbejë si një dritare e mirëfilltë zhvillimi për shoqërinë shqiptare. Përmes shtimit të kontakteve dhe shkëmbimeve me shoqëritë e tjera evropiane, ky hap konkret ndihmon për tu njohur nga afër me funksionimin e demokracive perëndimore, si dhe për të nxitur trysinë pozitive të shoqërisë ndaj autoriteteve shtetërore për të rritur llogaridhënien dhe përmirësuar punën e saj. Lëvizja e qytetarëve shqiptarë drejt hapësirës Shengen vazhdon pa episode bombastike, por me një vëmendje në rritje nga ana e vendeve të BE-së tashmë që po afron 15 marsi, ditë në të cilën mbushet 90 ditëshi i parë nga hyrja në fuqi e vendimit për heqjen e vizave. Ndërkohë që nga disa vende anëtare si Belgjika mbërrijnë pohime optimiste se nuk ka rritje të kërkesave për azil nga qytetarët shqiptarë, mbetet më i vështirë të përcaktohet numri i personave që qëndrojnë në hapësirën Shengen pa kërkuar azil, pra pa u regjistruar.

(vazhdon në faqen 3)

Avantazhet për studentët, hulumtuesit dhe akademikët

Procesi i liberalizimit të vizave ndihmon komunitetin e studentëve, hulumtuesve dhe pedagogëve, të cilët përmes programeve të shkëmbimit do të mund të rrisin kapacitetet e tyre profesionale. Heqja e regjimit të vizave u lehtëson të rinjve shqiptarë të profesioneve dhe disiplinave të ndryshme që, krahas pjesëmarrjes në konferenca, seminare, trajnime ndërkombëtare, të kenë mundësi të përfitojnë edhe nga programet e ndryshme të Bashkimit Europian.

Avantazhet për Komunitetin e Biznesit

Pas një periudhe të vështirë veprimi si pasojë e izolimit të gjatë për shkak të barrierave që paraqiste procesi i marrjes së një vize Shengen, liberalizimi i vizave pritet t'i japë frymëmarrje të re biznesit shqiptar. Radhët e gjata për marrjen e një vize, lista e gjatë dhe e kushtueshme e dokumenteve të detyrueshme për t'u paraqitur në konsullatat apo ambasadat e vendeve të Shengenit, dhe mbi të gjitha periudha e tej zgjatur në disa raste e procesit të verifikimit tashmë do të konsiderohen si një kapitull i mbyllur për biznesin vendas. Krahas rritjes së shkëmbimeve, përmirësime do të vihen re edhe në treguesit e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në konferenca, simpoziume, seminare, panaire dhe aktiviteteve të tjera ndërkombëtare tregtare që do të organizohen. Pjesëmarrja në këto aktiviteteve i ofron komunitetit shqiptar të biznesit mundësi bashkëpunimi me kompani të huaja të cilat shkëmbejnë mes tyre eksperiencë dhe njohuri në fushën e teknologjisë dhe marketingut.

Por ekziston edhe një rrezik që disa sektorë, kryesisht ai i turizmit apo konfeksioneve/veshjeve të dëmtohen nga prirja e qytetarëve për t'i përdorur kursimet e tyre për të udhëtuar apo kryer blerje në hapësirën Shengen.

(vijon nga faqja 2) Mbledhja e të dhënave nga çdo vend anëtar dhe identifikimi i saktë i numrit të individëve që shkelin afatet e qëndrimit është një proces i cili kërkon shumë kohë. Këtë e konfirmon edhe Komisionerja për Çështjet e Brendshme Cecilia Malmstrom, në takimin e Këshillit të Çështjeve të Brendshme dhe Drejtësisë së 24 shkurtit në të cilin ajo deklaroi se “Në lidhje me Shqipërinë dhe Bosnje Hercegovinën është ende herët të flitet për situatën pasi mungojnë të dhënat reale mbi vijueshmërinë e procesit të liberalizimit”. Ndërkohë, në një deklaratë për shtyp të kohëve të fundit, Ministri i Brendshëm, Lulëzim Basha konfirmoi se në dy muajt e parë nga liberalizimi i vizave kanë përfutur prej tij rreth 127 mijë qytetarë. Ndërkohë, një muaj nga mbushja e afatit 90 ditor, rreth 38 mijë janë kthyer.

Por lajmet e ditëve të fundit nga Brukseli flasin qartë se vendet e BE-së nuk janë akoma plotësisht të qeta. Këtë e konfirmon iniciativa e përbashkët e Hollandës dhe Francës, e cila shkon përtej masave të marra deri më tani të cilat parashikojnë monitorim të situatës nga ana e KE-së. Këto vende kanë kërkuar thjeshtëzimin e procedurave vendimmarrëse të BE-së për rikthim të mundshëm të regjimit të vizave, në rast të ballafaqimit me rrethana abuzuese nga një vend përfitues. Burime në Bruksel, pohojnë gjithashtu se vende të tjera, si për shembull Sllovakia kanë ngritur edhe shqetësime tjera që kanë të bëjnë me një impakt të mundshëm negativ të lëvizjes pa viza mbi trafikun e lëndëve narkotike, aktivitet të cilin vazhdojnë t’ia faturojnë Shqipërisë.

Në këtë pikë, është e rëndësishme që, si qytetarët shqiptarë, ashtu edhe institucionet të kuptojnë se procesi i liberalizimit të vizave nuk mund të quhet i mbyllur. KE vazhdon të monitorojë situatën dhe zbatimin e reformave dhe kuadrin ligjor. Në pritje të raportit të parë informues të KE-së për Këshillin e Ministrave të BE-së, duhet të vazhdojë informimi i saktë i qytetarëve mbi kushtet e lëvizjes pa viza.

Institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore duhet të maksimizojnë përpjekjet që liberalizimi i vizave të jetë një histori suksesi. Kjo jo vetëm për rëndësinë që ky hap ka për individët, por edhe për të përmirësuar imazhin e shoqërisë sonë në vendet anëtare të BE-së, të cilat në të ardhmen mund të kërkojnë organizimin e referendumeve kombëtare, për pranimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Etapat kyçe të Procesit të Liberalizimit të Vizave

Qershor 2003	Samiti i Selanikut: Konfirmoi perspektivën europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në të njëjtën kohë e lidhi çështjen e liberalizimit të vizave me stadin e reformave
Janar 2008	Hyn në fuqi Marrëveshja e Lehtësimit të Vizave
Maj 2008	5 Vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë) u dorëzohet Udhërrëfyesi drejt liberalizimit të vizave
Korrik 2009	Komisioni European i propozon Parlamentit European dhe Këshillit të Ministrave të BE-së heqjen e regjimit të vizave me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë. Kosova futet në listën e zezë të Shengenit.
Dhjetor 2009	Hyn në fuqi vendimi për heqjen e vizave për këto tre vende.
Maj 2010	Komisioni European i propozon Parlamentit European dhe Këshillit të Ministrave të BE-së heqjen e regjimit të vizave me Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën nëse tre standardet e mbetura për secilën përmbushen.
Tetor 2010	Parlamenti European voton pro heqjes së regjimit të vizave me këto dy vende.
Nëntor 2010	Këshilli i Ministrave të BE-së voton pro heqjes së regjimit të vizave me këto dy vende.
Dhjetor 2010	Hyn në fuqi vendimi për lëvizjen pa viza në zonën Shengen për qytetarët e Shqipërisë dhe Bosnje-Hercegovinës.

Stafi i EuroSpeak

Balazs: Mos i humbisni prioritetet tuaja! Dhe mos u tregoni të paduruar!

*Intervistë me Peter Balazs, Ministër i Punëve të Jashtme i Hungarisë (vitet 2009 - 2010)
dhe Komisioner i BE-së për Politikën Rajonale (viti 2004)*

(vijon nga faqja 1) për tregëtinë me jashtë. Në atë kohë i ndiqnim me vëmendje zhvillimet në Evropën perëndimore dhe më gjerë. Ishim një grup i vogël ekspertësh të rinj dhe dinamikë brenda MPJ-së të cilëve na u dha mundësia të mësonim mbi integrimin evropian. Dhe pikërisht në këtë pozicion mu dha rasti që, nëpërmjet udhëtimeve, të kuptoja që situata atje nuk ishte siç përshkruhej nga propaganda e cila e dënonte kapitalizmin, por integrimi dhe bashkëpunimi në të cilin këto vende ishin përfshirë ishte mjaft pozitiv. Duhet të theksoj se edhe gjatë komunizmit, në Hungari ka ekzistuar vazhdimisht një degë më reformiste në sistemin partiak, çka e bëri vendin tim ndër të parët që i përqafoi ndryshimet demokratike. Në vitet 80 u dërgova si diplomat në Bruksel dhe kjo ishte përvoja e cila më dha mundësitë më të mira që të mësoja nga puna e përditshme. Në vitin 2003, pra pak kohë përpara përfundimit të negociatave dhe hyrjes së Hungarisë në BE, mu caktua detyra e vështirë që të punoja për ngritjen e Përfaqësisë së Përhershme të Hungarisë pranë BE-së, duke u bërë edhe ambasadori i parë i saj. Kjo ishte një sfidë më vete e cila kërkonte rekrutimin pranë këtij institucioni të rreth 100 ekspertëve nga 11 ministri të ndryshme. Për më tepër, duke qenë se procesi i negociatave ka për partner Komisionin Evropian, nuk ishte gjithnjë e lehtë t'u shpjegoja kolegëve të mi në Hungari se ishte urgjent grumbullimi i ekspertëve të fushave të ndryshme që përpara anëtarësimit. Kjo për të qenë të përgatitur për ditën kur marrëdhënia do të zhvendosej drejt Këshillit të Ministrave të BE-së (kur edhe Hungaria të kishte karrigen e saj në tryezën e këtij institucioni). Më pas, kam mbuluar rolin e Komisionerit për Politikën Rajonale në Kabinetin e Z. Romani Prodi, një përvojë e shkurtër por mbresëlënëse për mua.

EuroSpeak: Angazhimi juaj në procesin e integritimit të Hungarisë në BE përshkon jo vetëm planin e institucioneve shtetërore, por tashmë edhe atë të shoqërisë civile? Nisur nga përvoja juaj, çfarë roli

mund të luajë shoqëria civile në këtë proces?

Balazs: Ata që e njohin procesin e integritimit janë të vetëdijshëm se në thelb, ai mbetet një proces elitari. Pak qytetarë janë të mirinformuar mbi institucionet dhe politikën e BE-së dhe pak ekspertë kombëtarë janë të përfshirë në të: sot vetëm rreth 300 ekspertë hungarezë janë staf i Komisionit Evropian. Hungaria ka 22 Deputetë në Parlamentin Evropian dhe pak mijëra funksionarë të ministrive udhëtojnë në Bruksel. Kjo mjafton për të ilustruar se vetëm një numër i kufizuar personash është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. Është pikërisht roli i shoqërisë civile e cila beson në avantazhet që ai mund të sjellë që t'i informojë dhe edukojë grupet e ndryshme të shoqërisë.

EuroSpeak: Ndër shumë detyrat e rëndësishme që ju keni mbuluar në vite, keni luajtur një rol aktiv në negociatat e Hungarisë për aderimin në BE, sidomos në periudhën e fundit para aderimit. Cilat janë këshillat që mund t'i jepni Shqipërisë si një vend që aspiron të gjendet së shpejti në tryezën e negociatave për anëtarësim?

Balazs: Mund të them se negociatat për anëtarësimin në BE sjellin një trysni të dyfishtë. Kjo sepse jo gjithnjë situata dhe nevoja për reformim në nivel kombëtar përputhen me prioritetet e integritimit evropian. Sot, pas 20 vitesh, në Hungari mund të shohim gabimet tona. Për një kohë të gjatë prioritetet na përcaktoheshin nga jashtë dhe përgjigja jonë ishte vazhdimisht "Si urdhëron!". Ndërkohë, u lanë pas dore reformat në ato fusha të cilat nuk monitoroheshin nga BE-ja si shëndetësia, edukimi, një administratë jo efiçente dhe e tepërt në numër, ndihma ndaj komunitetit rom, etj. Dhe sot na duhet të përballemi me probleme në këto sektorë të cilët kanë njohur hapa mbrapa gjatë viteve kur objektivi parësor ishte integrimi evropian. Prandaj, këshilla më e mirë që unë mund t'i jap Shqipërisë

nga përvoja hungareze është: **Në këtë proces, mos i humbisni prioritetet tuaja! Dhe mos u tregoni të paduruar!** Nuk dua t'ju zhgënjej, por ndonjëherë mund të jetë e rrezikshme të zhyteni në ujëra të thella. Luftoni për reforma dhe demokratizim të qëndrueshëm të vendit.

EuroSpeak: Flitet shumë për një "lodhje nga zgjerimi", sidomos nga ana e vendeve anëtare më të vjetra. Sipas jush, si mund të ndikojnë vendet e reja anëtare që ta zbusin këtë qëndrim dhe a ka realisht një predispozitë të tillë nga ana e tyre në favor të aderimit të Ballkanit Perëndimor në BE?

Balazs: Në përgjithësi vendet e reja anëtare janë mbështetëse të zgjerimit të mëtejshëm të BE-së. Ndër to bën pjesë padyshim edhe Hungaria. Ne e kuptojmë më mirë situatën në të cilën ju ndodheni, jemi më afër jush gjeografikisht dhe kemi nevojë për stabilitet. Ne e mbështesim zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor, por atë duhet ta promovojnë dhe njerëzit e thjeshtë, biznesmenët, etj. Ne e arritëm këtë nëpërmjet krijimit të Grupit të Vishegrad-it, i cili krijoi një bllok vendesh (Çekia, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia) që flisnin njëzëri. Aktualisht, ky grup po punon për të promovuar integrimin e Ballkanit Perëndimor në gjirin e BE-së.

Stafi i EuroSpeak

A po përjeton bota arabe një fllad pranveror?

Nisur nga ngjarjet e fundit në Lindjen e Mesme, Dominique Moisi, studiues in njohur i marrëdhënieve ndërkombëtare, autor i "Gjeopolitika e Emocioneve", themelues i Institutit Francez të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe profesor në Institute d'Etudes Politiques (Sciences Po), në shkrimin "A po përjeton bota arabe një fllad pranveror?" shtroi pyetjen nëse Tunizia do të ishte regjimi i parë autoritar që do të shkaktonte efektin domino në Lindjen e Mesme apo ajo duhet parë si një rast i pa precedent si për botën arabe ashtu edhe për vendet e Magrebit?

Ndonëse rezultati i revolucionit Jasmin nuk do të sjellë për Lindjen e Mesme ato rezultate që solli rënia e murit të Berlinit për Europën, së paku një gjë është e sigurt: Revolucioni Jasmin do të krijojë një ndarje "para" dhe "pas". Ndarja "pas", nxjerr në pah dy modele të mundshme të zhvillimit politik për botën arabe: nga njëra anë Turqia me rolin e saj influencues në Lindje dhe Irani me fundamentalizimin islamik nga ana tjetër. Por ajo që është e qartë është preferenca e Perëndimit për modelin turk dhe potencialit të saj për një rol stabilizues në këtë rajon. Sipas tij, është e rrezikshme të supozosh se pas Tunizisë, demokracia në botën arabe është vetëm një hap larg, ashtu sikurse është iluzion të besosh se pas ngjarjeve të fundit asgjë nuk do të ndryshojë. Pozitive ose negative qoftë, historia në botën arabe është në lëvizje - dhe Perëndimi nuk mund të bëjë shumë në lidhje me të.

Project Syndicate, 26 janar 2011

Kartolina nga BE-ja

S'ka më pushime në jahtet e diktatorëve!

Komisioni European ka ndaluar zyrtarët e lartë të kalojnë pushime në "jahtet e diktatorëve" dhe "avionët e oligarkëve" nëpërmjet një Kod të ri Sjelljeje për ta. Komisioni prezantoi Kodin e ri në datë 10 shkurt në një takim me kryetarët e grupeve parlamentare në Parlamentin European në të njëjtën javë kur u zbulua se Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm francez kanë pranuar udhëtime luksoze prej ish-liderit tunizian Zine El Abidine Ben Ali dhe homologu i tij egjiptian, Hosni Mubarak. Sipas kodit të ri, komisionerët nuk mund "të pranojnë mikpritjen, përveç se në përputhje me rregullat

e mirësjelljen diplomatike". Një zyrtar i BE-së tha: "Kjo do të thotë me një fjalë që, komisionerët mund të pranojnë ndihmë diplomatike vetëm kur udhëtojnë për qëllime zyrtare, por jo kur ata shkojnë me pushime." Ai shtoi se ndonëse mund të jetë e zakonshme për zyrtarë të lartë të kalojnë pushime me biznesmenë të rëndësishëm që i njohin prej vitesh, në të ardhmen edhe ky aktivitet do të duhet të autorizohet më parë, për tu siguruar se nuk ka konflikt me pozicionin dhe detyrat e tyre.

EU Observer, 11 shkurt 2011

Kartolina nga BE-ja

Më shumë se 249 ditë pa qeveri: Belgjika thyen rekordin iraken

Në datën 16 shkurt 2011, Belgjika kaloi 249 ditë pa qeveri, duke thyer kështu rekordin më të gjatë të krizës qeveritare, i cili mbahej deri më tani nga Iraku. Më pas, irakenëve u janë dashur 40 ditë për të formuar një qeveri. Ndërsa Mbreti i Belgjikës u ka dhënë dy javë kohë palëve që të t'i japin fund bllokimit politik në vend. Afati i fundit për një zgjidhje të mundshme ishte data 1 mars, tetë muaj pas zgjedhjeve parlamentare dhe refuzimeve të njëpasnjëshme për kompromis të shumicës flamande për të formuar një qeveri.

Euronews, 16 shkurt 2011



foto: free.fr

Ndërkohë, qytetarët protestojnë me humor

Në reagim ndaj situatës, nga studentë, artistë, etj. janë ndërmarrë iniciativa të ndryshme të cilat reflektojnë shpirtin paqësor dhe humorin e qytetarëve të Belgjikës.

Në shenjë proteste ndaj krizave të vazhdueshme politike, rreth 2000-3000 studentë nga komuniteti flamand e frankofon u mbledhën në Bruksel për të bërë "revolucionin e patateve të skuqura." Ata manifestuan për disa orë në qendër të kryeqytetit, të armatosur me birrë dhe patate të skuqura në duar për të mbrojtur unitetin e Belgjikës, i kërcënuar nga mosmarrëveshjet mes flamandëve dhe frankonëve. Ndërkohë, një nga aktorët më të njohur të Belgjikës, Benoit Poelvoorde, ka ndërmarrë nismën "Rrite Mjekarën për Belgjikën", duke u bërë thirrje bashkatdhetarëve të tij të mos rruhen deri sa në vend të formohet një qeveri. Kështu, janë me qindra ata që po e zgjasin mjekarën çdo ditë, duke qenë se Belgjika vazhdon të jetë pa qeveri (që nga zgjedhjet e qershorit të vitit të kaluar).

Stafi i EuroSpeak

Një karikues për të gjithë

Çdo vit mbi 185 milion telefona celularë shiten në BE, nga të cilët më shumë se 50 % janë telefona të rinj. Si rezultat telefonat e rinj bëjnë të papërdorshëm rreth 50.000 ton karikues të vjetër çdo vit, duke ditur që ekzistojnë mbi 30 modele të ndryshëm në qarkullim. Vlerësime të tjera flasin për më shumë se një miliard karikues të papërdorur në dollapët tanë.

Duke vlerësuar këtë situatë të dëmshme për mjedisin dhe konsumatorët, Komisioni Europian ndërmori iniciativën 'Një Karikues për të Gjithë', duke detyruar kompanitë prodhuese të përshtatin një model të njëjtë karikuesi për të gjithë celularët në formatin Micro-USB. Që prej Janarit 2011, të gjithë celularët e rinj do të shiten me karikuesin e ri universal.

Shumë shpejt ky standard mund të bëhet mbarëbotëror duke ndjekur suksesin e një tjetër standardi europian të vendosur për komunikimin e lëvizshëm, atë GSM (Global System for Mobile Communication) i cili tashmë mbulon 80% të tregut botëror. Për më tepër informacion, <http://onechargerforall.eu>.

Stafi i EuroSpeak



foto: itechnews

Këndvështrime

Fule: Spiraloja e rrezikshme kokëposhtë e Shqipërisë duhet të marrë fund



Në foto: S. Fule
Komisioner i KE

Duke iu referuar situatës politike në Shqipëri, Komisioneri për Zgjerimin, Fule deklaroi përpara pak ditësh para deputetëve të Parlamentit Evropian se “shtegu pa rrugëdalje dhe gjuha gjithnjë e më e hidhur që po dobëson institucionet në Shqipëri duhet të ndalet”.

Fule i bëri thirrje kryeministrit Sali Berisha që “të krijojë një mjedis politik me të vërtetë gjithëpërfshirës në Shqipëri”, në të cilin forcat e tjera politike dhe organizatat e shoqërisë civile do të përfitonin nga integrimi evropian. Ai gjithashtu i bëri thirrje liderit të opozitës socialiste, Edi Rama, “të garantojë që

partia e tij është një opozitë vërtet konstruktive dhe të veprjë me përgjegjësi”.

“Tonet në Tiranë nevojitet të ndryshojnë. Spiraloja e rrezikshme kokëposhtë duhet të përfundojë. Kriza politike duhet të zgjidhet. Kjo është përgjegjësi e përbashkët e liderëve politikë në Shqipëri,” tha Fule.

Stafi i EuroSpeak

Daniel Korski, studiues i European Council on Foreign Relations, në gazetën International Herald Tribune të 27 janarit 2011 në opinionin e titulluar “Ndal vetëshkatërrimit të Shqipërisë” shkruan se:

“Në një moment Shqipëria është vendi “që duhet vizituar patjetër në 2011” sipas Lonely Planet, anëtar i NATO-s, shtetasit e të cilëve gëzojnë të drejtën të udhëtojnë pa viza në Bashkimin Evropian, dhe në një moment tjetër forcat qeveritare po qëllojnë e vrasin protestuesit në rrugë e Ministria e Jashtme Britanike paralajmëron vizitorët të shmangin turmat e mëdha në Tiranë.

Kriza e tanishme, gjithsesi ka rrënjë të thella që lidhen me organizimin e drejtë e të ndershëm të zgjedhjeve si dhe korrupsionin e përhapur gjerësisht në vend. Rivalitetet e thellë, i udhëhequr nga personaliteti, midis Berishës dhe Ramës ka vepruar si një sharrë me dy njerëz, duke prodhuar fërkime të forta në çdo anë e duke prerë mes për mes institucionet e vendit si një copë druri”.

Në fund të editorialit të tij, Korski sugjeron se: “Bashkësia ndërkombëtare duhet të organizojë dhe drejtojë zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare vitin e ardhshëm, duke dërguar një mesazh të qartë se institucionet shqiptare nuk janë më të besuara apo të afta për t’i realizuar ato. Një qeveri e re me një axhendë konkrete për reforma duhet të krijohet. Këto masa mund të ndalin më në fund sharrimin e institucioneve të vendit nga politikanët e Shqipërisë.

Në qoftë se jo, ndikimi i krizës do të ndjehet përtej kufijve të Shqipërisë”.

International Herald Tribune, 27 janar 2011

Majlinda Bregu, Ministre e Integritimit dhe Zëdhënëse e Qeverisë Shqiptare i kundërpërgjigjet këtij artikulli në rubrikën “Letra dërguar International Herald Tribune”. Sipas ministres Bregu, “artikulli i Daniel Korskit habiti shumë nga ata të cilët janë të interesuar dhe informuar mbi Shqipërinë. Duke folur për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009, ai jep një tablo jo të plotë të vlerësimeve të OSBE-së. Gjithashtu reforma thelbësore fiskale të ndërmarra dhe lufta kundër korrupsionit kanë ndihmuar për të zhvilluar biznesin në vend. Më 21 janar, kreu i opozitës dështoi në përpjekjen e tij për të rrëzuar me dhunë një qeveri të ligjshme. Ne falënderojmë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian për mbështetjen e tyre për kapërcimin e situatës. Në Përputhje të plotë me ligjin, ne do të bëjmë çmos për të mbrojtur rendin kushtetues dhe për të sjellë shkelësit e tij para drejtësisë”.

Në mbyllje të letrës dërguar gazetës, Bregu shprehet se, “Argumentet e z. Korski janë akoma më të habitshme kur ai sugjeron që BE-ja duhet të shfuqizojë institucionet e Shqipërisë dhe t’ia fillojnë nga e para duke organizuar zgjedhje të reja, një masë që parashikohet vetëm në situata të pasluftës”.

International Herald Tribune, 13 shkurt 2011

Në pritje të aderimit...



foto: see.biz.eu

Aprovohet Plani i Veprimit në Përgjigje të Rekomandimeve të Opinionit të KE-së për Shqipërinë

Më 31 janar 2011, Komiteti Ndër-Ministror mbi Integrimin Europian miratoi Planin e Veprimit në Përgjigje të Rekomandimeve të Opinionit të KE-së për Shqipërinë, një dokument prej 91 faqesh i cili parashikon hapat konkretë që do të ndërmerren në muajt e ardhshëm me qëllim përmbushjen e 12 pikave të identifikuara në Opinionin e KE-së së nëntorit 2010. Plani ndan detyrat mes institucioneve duke përcaktuar gjithashtu afatet e zbatimit të aktiviteteve. Komisioni Europian do të vazhdojë të monitorojë punën për përmbushjen e 12 pikave gjatë muajve të ardhshëm për të dalë më pas, në vjeshtë, me një raport të ri mbi Shqipërinë. Nëse ecuria do të jetë domethënëse, vendit mund t'i jepet statusi kandidat për në BE.

Stafi i EuroSpeak

Një standard i ri?

Ish Ministri i Transportit Fatmir Limaj nuk është pjesë e qeverisë së re të Kosovës. Kjo për shkak të hetimeve për afera korruptive që kanë goditur Ministrinë e Transportit, gjatë qeverisjes së mëparshme dhe që janë ende në proces. Në fjalën e tij Z. Limaj iu referua komenteve të përfaqësuesit special të BE-së, Z. Peter Faith dhënë gjatë një interviste për RTK, ku çështja u cilësua më shumë etike sesa ligjore. Për komunitetin ndërkombëtar e rëndësishme është që politika të bazohet në vlerat e etikës dhe transparencës. Sipas Limaj, “ky standard duhet të zbatohet për të gjithë”.

Stafi i EuroSpeak

Mali i Zi nis debatin publik dhe aprovon Planin e Veprimit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Europian

Mali i Zi ka nisur debatin publik për Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të BE-së me diskutimin për reformën në administratën publike dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Partitë e opozitës dhe OJQ-të që morën pjesë në diskutim kritikuan draft dokumentin e qeverisë, duke argumentuar se në të mungon analiza e shërbimeve të sigurisë, policisë, punës së prokurorëve dhe gjyqësorit si dhe 19 vërejtjet në lidhje me sundimin e ligjit nuk janë të mjaftueshme për të gjitha reformat e nevojshme që duhen ndërmarrë. Pas seancave dëgjimore ku përfaqësuesit e të gjitha segmenteve të shoqërisë paraqitën pikëpamjet e tyre, Plani i Veprimit u finalizua për të përmbushur nevojat e vendit në rrugën drejt BE-së dhe për të siguruar burimet për realizimin e qëllimeve strategjike kombëtare. Ministrinë përkatëse do të sigurojnë rregullisht raportet mujore mbi rezultatet e punës së tyre, të cilat do të vihen në dispozicion për publikun e gjerë.

Balkaninsight, 2 dhe 18 shkurt 2011

Ballkani përëndimor në BE: Të jetë apo të mos jetë?

Në një opinion dhënë për EU Observer, në lidhje me anëtarësimin e Maqedonisë dhe vendeve të tjera të rajonit në BE, Ministri maqedonas i ekonomisë, Fatmir Besimi ngre shqetësimin se:

“Çdo zgjatje e mëtejshme e këtij procesi dhe vonesat në përfitime në krahasim me kostot i shtojnë argumentet e skeptikëve kundrejt optimistëve për të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, zgjatja inkurajon opsione politike nacionaliste në rajon, çka mund të çojë në izolimin e tij, kërcënimin e stabilitetit dhe rënien ekonomike.

Vendet e Ballkanit Perëndimor sot janë më afër se kurrë integritit në BE. Megjithatë, plotësimi kriterëve për integrimin ende mbetet një sfidë e madhe për këto vende. Ndoshta është koha që vendet e BE-së të synojnë të rrisin veprimin dhe intensitetin e mbështetjes për këtë rajon. Ballkani Perëndimor nuk është një barrë e madhe ekonomike për BE-në,

me një treg prej rreth 500 milionë banorë, ndërkohë që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një popullsi prej vetëm 23 milionë. Duke qenë se kostoja e mos-integrimit të këtyre vendeve në BE mund të jetë më e madhe se kostoja e integrimit në vetvete, mbështetja e BE-së është si ekonomikisht, ashtu dhe politikisht e drejtë”.

EU Observer, 8 dhjetor 2011

Eurodeputeti Swoboda shprehet se Kroacia mund t'i bashkohet BE-së në 2013

“Afati më i hershëm i mundshëm është 1 janari 2013 dhe më i voni 1 janari 2014” tha Hanes Swoboda, në një intervistë dhënë të përditshmes Jutarnji List, në lidhje me anëtarësimin e Kroacisë në BE.

“Anëtarësimi në 1 janar 2013 do të ishte një rekord dhe kërkon një procedurë jashtëzakonisht të shpejtë. Unë jam i kujdesshëm me parashikimet, në mënyrë që të shmangen zhgënjime të reja. Ne të gjithë duhet të bëjmë përpjekje për të arritur afatin më të shpejtë, që do të thotë në fillim të 2013,” theksoi ai.

Komentet e tij erdhën një ditë pasi Komiteti i Punëve të Jashtme i Parlamentit Evropian, tha se bisedimet e anëtarësimin të Kroacisë mund të përfundojë në gjysmën e parë të vitit, nëse reformat ecin në rrugën e duhur. Çështjet e pazgjidhura përfshijnë reformën e administratës publike, luftën kundër korrupsionit, mbështetje për kthimin e refugjatëve nga lufta e viteve 91-95’ dhe ristrukturimin e kantierëve portual shtetëror me humbje .

EUbusiness, 27 janar 2011

Serbët e Bosnjës i refuzojnë sugjerimet e BE-së për ndryshimet kushtetuese

Udhëheqësi i serbëve të Bosnjes u takua me Kancelaren gjermane Angela Merkel në Berlin, duke kundërshtuar qëndrimin e BE-se sipas të cilit Bosnja duhet të ndryshojë kushtetutën e saj për të forcuar qeverinë qendrore. Milorad Dodik zhvilloi bisedime me Merkel në Berlin dhe pas takimit deklaroi se serbët nuk duan që të zvogëlohet pushteti i rajonit serb të Bosnjes. Bosnja dëshiron të anëtarësohet në BE, por blloku 27-vendesh ka kërkuar reforma, duke përfshirë këtu dhe forcimin e pushtetit qendror.

Që nga lufta e viteve 1992-95, Bosnja është e ndarë në dy mini-shtete etnike - një i serbëve, dhe tjetri i boshnjakëve dhe kroatëve. Ata lidhen nga një qeveri qendrore e dobët. Serbët e Bosnjës kërcënojnë se do të sakrifikojnë anëtarësimin në BE nëse ai nënkupton zvogëlimin e pushtetit të mini-shtetit të tyre.

The Guardian, 12 shkurt 2011

Serbia i dorëzon KE-së përgjigjet e pyetësorit në kohë rekord

Serbia i përgatiti përgjigjet për pyetësorin në një kohë rekord prej vetëm 45 ditësh, çka mund të konsiderohet si një dëshmi e kapaciteteve të forta administrative, përpos parapërgatitjes eficiente që ishte kryer. Në ditën e dorëzimit të përgjigjeve, 31 janar 2011, Komisioneri për Zgjerimin Stefan Fule deklaroi se “dorëzimi i përgjigjeve është një ditë historike për Serbinë dhe një hap i rëndësishëm drejt marrjes së statusit kandidat dhe anëtarësimin në BE”.

Komisioni Evropian premtoi se do t'i vlerësonte përgjigjet e pyetësorit brenda katër deri gjashtë javësh dhe, nëse nevojitej, ai do t'i dërgonte pyetje shtesë Beogradit për të sqaruar disa nga përgjigjet. Pyetësori i KE-së, i cili mbulon të gjitha elementet e negociatave të ardhshme për anëtarësim midis Serbisë dhe BE-së, iu dorëzuar Serbisë më 24 nëntor 2010. Ai përmbante 2.483 pyetje, të klasifikuara në gjashtë anekse dhe 33 kapituj. Menjëherë pas dorëzimit, pyetësori u publikua në internet nga autoritetet serbe.

Stafi i EuroSpeak

A do të hiqen vizat për Turqinë?

Në takimin e tyre të 24 shkurtit, Ministrat e Brendshëm të BE-së kanë mbështetur një marrëveshje që i kërkon Turqisë të pranojë emigrantë e paligjshëm me origjinë nga Turqia, duke i dhënë kështu dritën e gjelbër një dialogu për vizat me Ankarën. Ndërkohë që Komisioni Evropian do që të flitet për liberalizimin e vizave, vendet anëtare me një nivel të lartë emigrantësh turq janë në favor të Lehtësimit të vizave për grupe të caktuara personash të tillë si studentët, akademikët dhe biznesmenët.

Turqia insiston në trajtimin e barabartë [me vendet e (vazhdon në faqen 10)]



(vijon nga faqja 9) Ballkanit Perëndimor]: Sipas Ministrit të jashtëm turk Ahmet Davutoglu, “pas kompromisit për marrëveshjen e ripranimit, rruga është e hapur për bisedime për liberalizimin e vizave.” Turqia nuk është e interesuar në bisedime për lehtësimin e vizave, por - si në rastin e vendeve të Ballkanit - në bisedime për liberalizimin e vizave. Ajo ndjehet e trajtuar në mënyrë të padrejtë: Ndërsa BE-ja është duke negociuar me Rusinë mbi heqjen e detyrimit të vizave, bisedimet me Turqinë, vend kandidat për anëtarësim në BE, as nuk kanë filluar. Megjithatë, sa realiste është heqja e detyrimit të vizave për turqit? Komisionerja e BE-së Cecilia Malmstrom, përgjegjëse për çështjet e vizave, është optimiste. Duke iu përgjigjur komenteve se ekzistojnë kritere të vështira për tu përmbushur në mënyrë që të arrihet liberalizimi i vizave, ajo tha : “Vende të tjera ia kanë dalë me sukses. Unë nuk shoh ndonjë arsye për Turqinë që të dështojë në përmbushjen e tyre”. Edhe nëse Komisioni Evropian merr dritën e gjelbër për të filluar një dialog për heqjen e vizave me Turqinë, mbetet e pasigurt nëse bisedimet mund të mbyllën po aq shpejt sa në rastin e vendeve të Ballkanit perëndimor.

Hurriyet Daily News, 27 shkurt 2011

Lëvizja Europiane në Shqipëri është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit evropian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritit evropian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit evropian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave evropiane si dhe i procesit të integritit evropian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit evropian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Publikimet dhe Aktivitetet e fundit të EMA-s:

*Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë
www.em-al.org*

Policy paper: Selanik 2014: Në kërkim të riafirmimit të besueshmërisë së procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, janar 2011

Policy paper, Skenarët e një aplikimi, Në pritje të Opinionit të Komisionit Evropian për aplikimin e Shqipërisë në BE, nëntor 2010

Konferencë: Selanik II – Rruga për të kapërcyer status quo-n e procesit të zgjerimit të BE-së?

Për komente, sugjerime ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org



Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri – OSFA.